



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT
DIBËR

PREFEKTURA DIBËR
Ardhur
Nr. 473 dt. 24.04.23

Nr. 81/2 prot.

Peshkopi, më 13. 04.2023

VENDIM

Nr. 02, date 13.04. 2023

**“PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË AKTIVITETEVE ARTISTIKE, KULTURORE,
SOCIALE, SPORTIVE E PROMOVUESE PËR VITIN 2023”**

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 77, gërma “k”, neni 82, gërma “b”, në VKM nr. 1173, datë 06.11.2009 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura”, Këshillit i Qarkut Dibër në mbledhjen e datës 13.04.2023, pasi shqyrtoi Vendimin e Kryesisë “Për miratimin e kalendarit të aktiviteteve artistike, kulturore, sociale, sportive e promovuese për vitin 2023”, me **10 vota pro**,

VENDOSI:

1. Të miratojë kalendarin e aktiviteteve artistike, kulturore, sociale, sportive e promovuese për vitin 2023 sipas **lidhjes 1** që i bashkëlidhet këtij Vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Aktivitetet e mësipërme do të organizohen nga njësitë e qeverisjes vendore të nivelit të parë me pjesëmarrjen, në disa raste në bashkëpunim, me Këshillin e Qarkut.
3. Për aktivitetet e përbashkëta me bashkitë ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut për nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit.
4. Vendimi ti dërgohet institucionit të Prefektit për verifikimin e ligjshmërisë.
5. Me zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen Kabineti i Kryetarit dhe Sektori Juridik dhe Projekteve.
6. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.
7. U shpall në Peshkopi, sot datë 13.04.2023.

KRYETAR

Valentina Haliti

Adresa: Bulevardi "Elez Isufi" Peshkopi, Tel & Fax ++355(0) 218 223 24 www.qarkudiber.gov.al